

NR. PROT. 157

DAT E 06.03.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 43/12 Prot.

Tiranë, më 01.03.2024

LËNDA: Përcillet vendimi i Bordit të Akreditimit

KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"

Kompleksi "Xhura", Nr. 12, Rruga Xhanfize Keko, Porcelan,

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 13 Janar 2024, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të disa programeve të studimit.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 53 datë 13.01.2024.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Xhiliola Bixheku



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 53, datë 13.01.2024

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË “MARKETING DIGJITAL”, TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 13.01.2024, në kuadër të vendimarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Marketing Digjital”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në “Marketing Digjital”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 345, datë 17.09.2021
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologji Informacioni
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra
- g) Kredite (ECTS): 120 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Formati i syllabuseve të këtij programi studimi, nuk është në përputhje me formatin e parashikuar në aktet nën ligjore në fuqi.
 2. Mungesa e një raporti analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, të lidhura në funksion të këtij programi studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master i Shkencave në **“Marketing Digjital”**, të Kolegjit Universitar **“Instituti Kanadez i Teknologjisë”**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **12.01.2029**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar
INDRIT HOXHA		Anëtar